



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.102

2005

janar

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.811, datë 16.12.2005	Për miratimin e projektit për financimin e shërbimit të kujdesit shëndetësor parësor, në qarkun e Beratit, nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor si burim i vetëm.....	3227
Vendim i KM nr.815, datë 28.12.2005	Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale”.....	3227
Vendim i KM nr.816, datë 28.12.2005	Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës për shpëtim dhe ristrukturim”.....	3230
Vendim i KM nr.817, datë 28.12.2005	Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”.....	3235
Vendim i KM nr.822, datë 28.12.2005	Për disa ndryshime në vendimin nr.127, datë 11.3.2004 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Komitetit Shtetëror të Minoriteteve”.....	3242
Vendim i KM nr.825, datë 28.12.2005	Për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Statistikave.....	3243

VENDIM
Nr.811, datë 16.12.2005

PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT PËR FINANCIMIN E SHËRBIMIT TË KUJDESIT SHËNDETËSOR PARËSOR, NË QARKUN E BERATIT, NGA INSTITUTI I SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR SI BURIM I VETËM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 36 të ligjit nr.7870, datë 13.4.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 24 e 26 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit për financimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor (KSHP), në qarkun e Beratit, nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, si burim i vetëm.
 2. Ky financim të fillojë nga data 1 janar 2006.
 3. Për përgatitjen e udhëzimeve për përcaktimin e statusit, të misionit, funksioneve të paketës bazë të shërbimeve, që duhet të ofrojnë këto institucione, si dhe të nivelit të autonomisë së tyre, financiare e menaxheriale, ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.
 4. Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, mbështetur në paketën e shërbimeve, që do të ofrojnë institucionet publike të kujdesit shëndetësor parësor, të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë, të hartojë, negociojë dhe të lidhë kontrata shërbimi me institucionet publike të kujdesit shëndetësor parësor të qarkut të Beratit.
 5. Kontrata e shërbimit të parashikojë mbulimin e shpenzimeve të institucionit publik vetëm për ofrimin e shërbimeve (pa përfshirë financimin e investimeve kapitale), një pagesë fikse për shpenzimet për ushtrimin e veprimtarisë së këtij institucioni, si dhe një pagesë, në bazë të nivelit të institucionit në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor.
 6. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë, që, pas miratimit të buxhetit të saj për vitin 2006, t’i kalojë Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor fondet buxhetore, të parashikuara për shpenzimet korente për vitin 2006 (shpenzime personeli dhe shpenzime operative) për shërbimin e kujdesit shëndetësor parësor të qarkut të Beratit.
 7. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.815, datë 28.12.2005

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KUSHTET DHE PROCEDURAT E DHËNIES SË NDIHMËS RAJONALE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 14, pika 2, e 36 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- Miratimin e rregullores “Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
PËR KUSHTET DHE PROCEDURAT E DHËNIES SË NDIHMËS RAJONALE

Neni 1

Qëllimi dhe fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore përcakton kushtet dhe procedurat e posaçme për dhënien e ndihmës rajonale.
2. Kjo rregullore nuk zbatohet për ndihmën për shpëtimin dhe ristrukturimin e ndërmarrjeve në vështirësi. Kjo kategori do të shqyrtohet në bazë të rregullores “Për kushtet dhe procedurat për dhënien e ndihmës për shpëtim dhe ristrukturim”.

Neni 2

Përkufizime

Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

“Ndihma rajonale” është ndihma sipas përcaktimit të bërë në ligj. Në kuptim të kësaj rregulloreje, i gjithë territori i Republikës së Shqipërisë do të konsiderohet si një zonë e prapambetur.

“Investim fillestar” është investimi në kapital të patundshëm për ngritjen e një ndërmarrjeje të re, për zgjerimin e një ndërmarrjeje ekzistuese, për rritjen e llojshmërisë së produkteve, nëpërmjet prodhimit të produkteve të reja tregtare, për ndryshime thelbësore të produkteve ose të proceseve të prodhimit, si dhe për blerjen e një ndërmarrjeje, një linje prodhimi apo dege të saj, që është mbyllur ose që do të mbyllet nëse nuk do të blihej.

“Krijimi i vendeve të reja të punës” është rritja neto e numrit të vendeve të punës në një ndërmarrje të veçantë, në krahasim me mesataren për një periudhë kohore të caktuar.

“Numri i vendeve të punës” është numri i njërive vjetore të punës (NVP), që është numri i të punësuarve me kohë të plotë gjatë një viti. Puna me kohë të pjesshme dhe puna sezonale llogariten si fraksion i njërive vjetore të punës.

“Ndihma operacionale” është ndihma që jepet për të ulur shpenzimet korrente të ndërmarrjes.

“Intensiteti i ndihmës shtetërore” është ekuivalenti sipas përcaktimit të bërë në ligj.

“Ndërmarrje të vogla dhe të mesme” janë ndërmarrjet sipas përcaktimit të bërë në ligj.

“Ndërmarrje të mëdha” janë ndërmarrjet, që nuk përfshihen në përkufizimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Neni 3

Kushtet e përgjithshme

1. Ndihma rajonale mund të jepet vetëm për të mbështetur investimin fillestar ose krijimin e vendeve të reja të punës, të lidhura me këtë investim.

2. Ndihma për investimin fillestar dhe ndihma për krijimin e vendeve të reja të punës kushtëzohen nëpërmjet mënyrës së pagesës dhe jepen vetëm nëse ruajnë investimin ose vendet e krijuara të punës për një periudhë prej të paktën pesë vjetësh.

3. Në skemat e ndihmës rajonale dhe ndihmat individuale duhet të përcaktohet se kërkesa për ndihmë nga përfituesit të dorëzohet te dhënësit e ndihmës përpara se të fillojë puna me projektet.

4. Në rast se ndihma është subjekt i njoftimit individual në Drejtorinë e Ndihmës Shtetërore (në vazhdim “drejtoria”) dhe i miratimit nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore (në vazhdim “komisioni”), ndihma nuk vihet në zbatim përpara se komisioni të marrë një vendim për lejimin e saj, me ose pa kushte.

Neni 4

Kushtet për dhënien e ndihmës për investim fillestar

1. Ndihma për investim fillestar llogaritet si përqindje e vlerës së investimit në aktive të prekshme dhe të paprekshme.

2. Kontributi i përfituesit për financimin e investimit fillestar duhet të jetë të paktën 25 për qind. Kontributi minimal nuk duhet të përmbajë dhe nuk duhet të mbështetet nga asnjë formë tjetër ndihme.

3. Kostot e pranueshme të investimeve të prekshme janë kostot që lidhen me investimet për tokën, ndërtesat, makineritë dhe pajisjet.

4. Kostot e pranueshme të investimeve të paprekshme janë kostot, që lidhen me transferimin e teknologjisë, nëpërmjet zotërimit të patentave, licencave operacionale dhe licencave të njohurive, të mbrojtura dhe të pambrojtura, me kusht që ato:

- a) të përdoren vetëm në ndërmarrjen, linjën apo degën e saj, për të cilën merret ndihma rajonale;
- b) të konsiderohen si aktive të amortizueshme;
- c) të blihen nga palët e treta me kushtet e tregut;
- d) të përfshihen në aktivet e ndërmarrjes, linjës apo degës së saj, që merr ndihmë rajonale dhe të qëndrojnë në të për një periudhë jo më pak se pesë vjet.

Neni 5

Intensiteti i ndihmës

1. Intensiteti i ndihmës për investim shprehet në ekuivalentin neto të grantit (ENG).¹
2. Intensiteti i ndihmës rajonale nuk duhet të kalojë 50 për qind të ENG-së, me përjashtim të zonave të thella, ku ai mund të arrijë deri në 65 për qind të ENG-së.
3. Kufijtë e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, mund të rriten për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme me 15 për qind të vlerës bruto, me kusht që vlera neto e intensitetit të ndihmës të mos kalojë 75 për qind.

Neni 6

Kushtet për dhënien e ndihmës për krijimin e vendeve të reja të punës

1. Ndihma për krijimin e vendeve të reja të punës duhet të jetë e lidhur me një projekt për investim fillestar.
2. Një vend pune quhet i lidhur me një projekt investimi, nëse ai i përket veprimtarisë për të cilën kryhet investimi dhe nëse krijohet brenda tri vjetëve nga përfundimi i investimit.
3. Vlera e ndihmës për krijimin e vendeve të reja të punës nuk duhet të kalojë një përqindje të caktuar të pagës mesatare të personave të punësuar, të llogaritur për një periudhë 2-vjeçare². Përqindja është e barabartë me intensitetin e lejuar për ndihmën për investim.

Neni 7

Ndihma operacionale

Ndihma operacionale është e ndaluar, me përjashtim të rasteve kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- a) Ndihma është e justifikuar për shkak të natyrës së saj dhe për kontributin që jep në zhvillimin rajonal;
- b) Vlera e saj është në përpjesëtim me mangësitë që kërkon të rregullojë;
- c) Ndihma është e kufizuar në kohë dhe zvogëlohet në mënyrë progresive.

Neni 8

Kushtet për akumulimin e ndihmës

1. Kufiri më i lartë i intensitetit të ndihmës, i përcaktuar në nenin 4 të kësaj rregulloreje, zbatohet edhe për totalin e ndihmës, kur ajo jepet paralelisht nëpërmjet skemave të ndryshme rajonale, pavarësisht nëse është dhënë nga burimet kombëtare apo vendore.
2. Ndihma për investimin fillestar dhe ndihma për krijimin e vendeve të reja të punës mund të kombinohen, me kusht që të ruhet niveli më i lartë i intensitetit, i përcaktuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje. Ky kusht përmbushet nëse shumica e ndihmës për investimin fillestar, e shprehur në përqindje të këtij investimi dhe e ndihmës për krijimin e vendeve të reja të punës, e shprehur si përqindje e kostos së pagave, nuk kalon vlerën më të favorshme të kufijve më të lartë të intensitetit, të përcaktuar në nenet 5 dhe 6 të kësaj rregulloreje.
3. Kur shpenzimet e pranueshme për ndihmën rajonale janë të pranueshme, pjesërisht ose tërësisht,

¹ Metoda për llogaritjen e ENG-së është dhënë në aneksin I.

² Të dhënat që do të përdoren në analizën për pagën mesatare të punonjësve përcaktohen nga [...]

edhe për ndihmën që jepet për qëllime të tjera, pjesa e përbashkët do të llogaritet në bazë të kufirit më të favorshëm të skemave në fjalë.

4. Kur dhënësi i ndihmës parashtron kërkesën se ndihma nëpërmjet një skeme mund të kombinohet me ndihmën nëpërmjet skemave të tjera, ai duhet të përcaktojë, për secilën skemë, metodën, në bazë të së cilës do të sigurojë përputhshmërinë me kushtet e dhëna më sipër.

Neni 9

Procedurat

1. Ndihma rajonale jepet në bazë të procedurave të përcaktuara në kreun III të ligjit, si dhe në rregulloren “Për procedurat dhe formën e njoftimit”.

2. Në rastin e ndihmës rajonale, çdo plan për dhënien e një ndihme të re do t’i njoftohet dhënësit të ndihmës, duke plotësuar formularin e dhënë në aneksin II të kësaj rregulloreje.

Neni 10

Nxjerrja e udhëzimeve dhe dokumenteve të tjera

Komisioni mund të nxjerrë udhëzime dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm në zbatim të kësaj rregulloreje.

VENDIM

Nr.816, datë 28.12.2005

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KUSHTET DHE PROCEDURAT E DHËNIES SË NDIHMËS PËR SHPËTIM DHE RISTRUKTURIM”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 15, pikat 4 e 5, dhe 36 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e rregullores “Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës për shpëtim dhe ristrukturim”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE

PËR KUSHTET DHE PROCEDURAT E DHËNIES SË NDIHMËS PËR SHPËTIM DHE RISTRUKTURIM

Neni 1
Qëllimi dhe fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore përcakton rregulla të posaçme për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës për shpëtim dhe ristrukturim.

2. Kjo rregullore nuk zbatohet për:

a) skemat e përgjithshme të sigurimeve shoqërore, sipas së cilave përfitimet shtesë dhe pensionet e parakohshme i paguhen drejtpërdrejt punonjësve të larguar nga puna për arsye të ristrukturimit;

b) skemat e përgjithshme të ndihmës sociale, të dhëna nga shteti për të mbuluar koston e ndërmarrjeve, që japin përfitime për punonjësit e larguar nga puna, për arsye të ristrukturimit, duke tejkaluar detyrimet e tyre statutores ose kontraktuale.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë rregullore, termit e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

“Ndërmarrje në vështirësi” është ndërmarrja sipas përkufizimit të bërë në ligj.

“Ndihma shtetërore për rastet e shpëtimit” është mbështetja financiare sipas përkufizimit të bërë në ligj.

“Ndihma shtetërore për ristrukturim” është mbështetja financiare sipas përkufizimit të bërë në ligj.

“Ndërmarrje të vogla dhe të mesme” janë ndërmarrjet që kanë jo më shumë se 250 punonjës dhe një xhiro vjetore jo më të madhe se 40 milionë euro ose një llogari të bilancit jo më të madhe se 27 milionë euro dhe që nuk janë të zotëruara në një masë më të madhe se 25 për qind të kapitalit ose të së drejtës së votës nga një ose disa ndërmarrje, që nuk cilësohen si ndërmarrje të vogla dhe të mesme.

“Ndërmarrje të mëdha” janë ndërmarrjet që nuk përfshihen në përkufizimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Neni 3
Veçoritë dalluese të ndërmarrjes në vështirësi

Ndërmarrje në vështirësi kemi në rastet kur:

a) një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ka humbur gjysmën e kapitalit të vet të regjistruar dhe më shumë se 1/4 e vlerës së këtij kapitali e ka humbur gjatë 12 muajve pararendës;

b) një shoqëri, në të cilën të paktën disa prej anëtarëve të saj kanë përgjegjësi të pakufizuar për borxhet e shoqërisë, ka humbur, siç tregohet në librat e kontabilitetit, më shumë se gjysmën e kapitalit të vet, si dhe më shumë se 1/4 e vlerës së këtij kapitali e ka humbur gjatë 12 muajve pararendës;

c) një ndërmarrje shfaq shenjat dalluese të një ndërmarrjeje në vështirësi, të tilla si: rritja e humbjeve, ulja e xhiros, rritja e stokut të inventarit, kapaciteti i tepërt, ulja e qarkullimit të parave, rritja e borxheve, rritja e pagesave të interesit dhe ulja në zero e vlerës neto të aseteve;

d) pavarësisht nga lloji i ndërmarrjes në fjalë, përmbushen kushtet e parashikuara në legjislacionin shqiptar për hapjen e procedurave të falimentimit.

Neni 4
Përjashtimet nga fusha e zbatimit

1. Një ndërmarrje e sapokrijuar nuk mund të përfitojë ndihmë shtetërore për shpëtim dhe ristrukturim gjatë tri viteve të para të veprimtarisë së vet, pavarësisht nëse gjendja e saj financiare është e pasigurt. Një ndërmarrje e krijuar nga një ndërmarrje tjetër, me qëllimin për të marrë asetet apo detyrimet e kësaj të fundit, nuk konsiderohet ndërmarrje e sapokrijuar.

2. Një ndërmarrje që i përket ose është blerë nga një grup i madh ndërmarrjesh, nuk mund të përfitojë ndihmë shtetërore për shpëtim dhe ristrukturim, përveç rasteve kur vërtetohet se vështirësitë e saj janë të brendshme dhe nuk janë rezultat i alokimit arbitrar të kostos, brenda grupit të ndërmarrjeve, si dhe vështirësitë janë shumë serioze që të përballen nga vetë grupi. Kur një ndërmarrje në vështirësi krijon një filial të vetin, ajo, së bashku me filialin e krijuar, do të konsiderohen si një grup ndërmarrjesh dhe mund të përfitojnë ndihmë për shpëtim dhe ristrukturim.

Neni 5
Kushtet e përgjithshme

1. Ndhimja për shpëtim dhe ristrukturim mund të lejohet vetëm për ndërmarrjet që plotësojnë kriteret për t'u cilësuar si ndërmarrje në vështirësi.

2. Ndhimja për shpëtim dhe ristrukturim mund të lejohet vetëm një herë. Dhënësit e ndihmës shtetërore (këtej e tutje "dhënësit") duhet të japin të dhëna të sakta nëse ndërmarrja në fjalë ka përfituar më parë ndihmë për shpëtim dhe ristrukturim, si dhe çdo ndihmë tjetër, të dhënë përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

3. Ndhimja për shpëtim dhe ristrukturim nuk do të lejohet, derisa përfituesi të rimbursojë çdo ndihmë të dhënë më parë të deklaruar si të paligjshme.

4. Ndhimja për shpëtim dhe ristrukturim mund të lejohet më shumë se një herë, vetëm nëse kanë kaluar 10 vjet që nga dhënia e ndihmës së mëparshme për shpëtim dhe ristrukturim. Komisioni i Ndhmës Shtetërore (këtej e tutje "komisioni") mund të lejojë ndihmë të mëtejshme për shpëtim dhe ristrukturim përpara mbarimit të afatit dhjetëvjeçar, vetëm në rrethana, përjashtimore dhe të paparashikuara, të cilat nuk mund të shmangeshin nga ndërmarrja dhe për të cilat ajo nuk është përgjegjëse.

Neni 6
Kushtet për dhënien e ndihmës për shpëtim

1. Në mënyrë që të lejohet ndihma për shpëtim, duhet:

a) të jetë ndihmë në likuiditete, në formën e huave ose garancive të huave. Huatë duhet të jepen me çmimin e tregut;

b) të jetë e kthyeshme dhe të gjitha garancitë ose huatë duhet të përfundojnë brenda një periudhe jo më të gjatë se gjashtë muaj pas disbursimit të pagesës së parë në llogari të ndërmarrjes;

c) të jetë e justifikuar për arsye të vështirësive serioze sociale;

d) të kushtëzohet nga paraqitja e njoftimit në kohën e duhur nga dhënësit pranë komisionit, të shoqëruar me një plan ristrukturimi ose plan likuidimi, a me një dokument, ku vërtetohet se huaja është rimbursuar plotësisht dhe/ose afati i garancisë ka përfunduar;

e) të jetë e kufizuar deri në vlerën e nevojshme për ta mbajtur ndërmarrjen në veprim gjatë periudhës që jepet ndihma.

2. Ndhimja për shpëtim jepet për gjashtë muaj ose, kur dhënësit kanë paraqitur një plan ristrukturimi gjatë kësaj periudhe, afati do të shtyhet deri në çastin kur komisioni merr vendim për ndihmën, përveç rasteve kur ky komision vendos se shtyrja e këtij afati nuk është e justifikuar.

Neni 7
Kushtet për dhënien e ndihmës për ristrukturim

1. Komisioni lejon dhënien e ndihmës për ristrukturim, nëse zbatohet një plan ristrukturimi rentabël, i miratuar nga dhënësi dhe i pranuar nga komisioni.

2. Vlera dhe intensiteti i ndihmës duhet të jenë të kufizuara deri në vlerën e kostos së nevojshme për ristrukturim, në përputhje me burimet financiare ekzistuese të ndërmarrjes, aksionarët e saj ose grupin e ndërmarrjeve që i përkasin asaj, si dhe me ndihmat e përfituara më parë për shpëtim.

3. Përfituesit e ndihmës duhet të mbulojnë me burimet e veta pjesën më të madhe të kostos së planit të ristrukturimit, gjë që mund të kërkojë edhe shitjen e aseteve që nuk janë jetike për ndërmarrjen.

4. Vlera e ndihmës ose forma në të cilën jepet ndihma nuk duhet t'i sigurojë ndërmarrjes tepëri të ardhurash, të cilat mund të përdoren në mënyrë agresive për veprimtari që shtrembërojnë tregun dhe që nuk lidhen me procesin e ristrukturimit.

5. Ndhimja nuk duhet të përdoret për të financuar një investim të ri, që nuk është thelbësor për rikthimin e rentabilitetit të ndërmarrjes.

Neni 8
Plani i ristrukturimit

1. Plani i ristrukturimit duhet të përmbushë të gjitha kushtet e përcaktuara në pikat 2, 3, 4 e 5 të nenin 7 të kësaj rregulloreje.

2. Plani i ristrukturimit duhet:

- a) të ketë një kohëzgjatje sa më të shkurtër;
- b) të rikthejë rentabilitetin afatgjatë të ndërmarrjes brenda një periudhe kohore të arsyeshme, e cila, në parim, nuk duhet të jetë më e gjatë se 5 vjet, si dhe të bazohet në vlerësimin real të faktorëve operativë dhe të rezultateve të pritshme;
- c) të sigurojë që përmirësimi i rentabilitetit është rezultat i masave të brendshme, të përfshira në planin e ristrukturimit;
- d) të parashikojë heqjen e veprimtarive që do të vazhdojnë të kenë humbje edhe pas ristrukturimit;
- e) të përshkruajë rrethanat që çuan ndërmarrjen në vështirësi, që do të përbëjnë bazën e vlerësimit, nëse masat e propozuara janë të përshtatshme;
- f) të marrë parasysh, ndër të tjera, gjendjen aktuale dhe parashikimet në të ardhmen për ofertën dhe kërkesën në tregun e produktit përkatës, të shoqëruar me disa plane veprimi, që reflektojnë rastin më të mirë, rastin më të keq dhe supozimet e ndërmjetme, si dhe pikat e forta dhe ato të dobëta të ndërmarrjes;
- g) të mundësojë që ndërmarrja, pas përfundimit të ristrukturimit, të jetë e aftë të mbulojë të gjitha kostot e veta, duke përfshirë zhvlerësimin dhe detyrimet financiare, si dhe që kthimi i pritshëm i kapitalit të jetë i mjaftueshëm për ndërmarrjen, në mënyrë që të konkurrojë në treg me aftësitë e veta.

Neni 9

Masat kompensuese për ndihmën për ristrukturim

1. Masat kompensuese jepen me vendim të komisionit për uljen, sa më shumë të jetë e mundur, të efekteve negative për kushtet e tregtisë.
2. Si masa kompensuese mund të vlerësohen: ndarja e aseteve, ulja e kapaciteteve, vendosja e kufizimeve për pjesëmarrjen e ndërmarrjes në tregun përkatës dhe ulja e barrierave të hyrjes në tregjet përkatëse.
3. Në vendosjen e masave kompensuese duhet të mbahen parasysh nevojat e zhvillimit rajonal.
4. Kur përfituesi është një ndërmarrje e vogël dhe e mesme ose pjesa e tregut që zotëron ndërmarrja në tregun e përbashkët të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit European është e papërfillshme (ose është më e vogël se 10 për qind), detyrimi për vendosjen e masave kompensuese nuk zbatohet.

Neni 10

Kushtet për dhënien e skemave të ndihmës për shpëtim dhe ristrukturim për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

1. Komisioni lejon skemat e ndihmës për shpëtim për ndërmarrjet në vështirësi, të vlerësuara ndërmarrje të vogla dhe të mesme sipas pikës 3 të nenit 3 të ligjit, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:
 - a) Të jetë ndihmë në likuiditete në formën e huave ose garancive të huave. Huatë duhet të jepen me çmimin e tregut;
 - b) Të jetë e kthyeshme dhe të gjitha garancitë ose huatë duhet të përfundojnë brenda një periudhë jo më të gjatë se gjashtë muaj pas disbursimit të pagesës së parë, në llogarinë e ndërmarrjes;
 - c) Të jetë e justifikuar për arsye të vështirësive serioze, sociale;
 - d) Të kushtëzohet nga paraqitja e njoftimit në kohën e duhur nga dhënësit pranë komisionit, të shoqëruar me një plan ristrukturimi apo plan likuidimi, ose një evidencë, ku vërtetohet se huaja është rimbursuar plotësisht dhe/ose afati i garancisë ka përfunduar;
 - e) Të jetë e kufizuar deri në vlerën e nevojshme për ta mbajtur ndërmarrjen në veprim gjatë periudhës që jepet ndihma.
2. Skemat duhet të përcaktojnë vlerën maksimale të ndihmës, që mund të përfitojë një ndërmarrje si pjesë e planit për dhënien e ndihmës për shpëtim dhe/ose ristrukturim, duke përfshirë edhe rastin kur ky plan pëson ndryshime. Kjo vlerë nuk mund të jetë më e madhe se 10 milionë euro, duke përfshirë edhe vlerën e ndihmave të përfituara nga burime të tjera ose nga skema të tjera ndihme.
3. Komisioni lejon skemat e ndihmës për ristrukturim për ndërmarrjet në vështirësi, të ndërmarrjeve të vlerësuara të vogla dhe të mesme, sipas pikës 3 të nenit 3 të ligjit, nëse plotësohen kushtet e përcaktuara në nenet 7, 8 e 9 të kësaj rregulloreje.
4. Skemat duhet të sigurojnë që ndërmarrjet përfituese të mos rrisin kapacitetin e tyre gjatë ristrukturimit.

Neni 11

Procedurat për miratimin dhe pranimin e planit të ristrukturimit

1. Dhënësit duhet të miratojnë planin e ristrukturimit përpara njoftimit të këtij plani pranë komisionit. Vendimi për miratimin ose jo të planit të ristrukturimit duhet të merret në bazë të një analize të hollësishme të planit, të kryer nga dhënësit ose me mbështetjen e një eksperti të pavarur.

2. Një plan ristrukturimi nuk mund të miratohet, nëse ai nuk siguron rentabilitetin e ndërmarrjes në vështirësi brenda periudhës së parashikuar në plan. Në këtë rast, çdo ndihmë e dhënë për shpëtim duhet të rimbursohet.

3. Komisioni pranon planin e ristrukturimit brenda afatit kohor të përcaktuar në nenin 22 të ligjit. Komisioni mund të kërkojë informacion shtesë, në përputhje me nenin 24 të ligjit.

Neni 12

Zbatimi i planit të ristrukturimit dhe plotësimi i kushteve

1. Planin e ristrukturimit dhe çdo detyrim tjetër duhet të zbatohen plotësisht. Mosrespektimi i planit ose i detyrimeve do të vlerësohen nga komisioni si ndihmë e paligjshme.

2. Në rastin kur plani i ristrukturimit ka një kohëzgjatje disavjeçare dhe kur vlera e ndihmës është e madhe, komisioni mund të kërkojë ndarjen e ndihmës për ristrukturim në pagesa periodike, me kusht që, paraprakisht, të ketë marrë konfirmimin nga përfituesi se do të zbatojë planin në përputhje me afatet kohore të përcaktuara në këtë plan.

Neni 13

Ndryshimi i planit të ristrukturimit

1. Gjatë periudhës së ristrukturimit, dhënësit mund të njoftojnë Drejtorinë e Ndihmës Shtetërore (këtej e tutje “drejtoria”) për çdo ndryshim të planit të ristrukturimit dhe të vlerës së ndihmës. Komisioni mund t’i pranojë ndryshimet, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

- a) Planin i rishikuar garanton kthimin e rentabilitetit, brenda një afati kohor të arsyeshëm;
- b) Masat kompensuese janë të nevojshme;
- i) Nëse vlera e ndihmës është rritur, çdo masë kompensuese duhet të jetë më gjithëpërfshirëse se masat e marra më parë;
- ii) Nëse masat kompensuese të propozuara janë më të vogla se ato të planifikuara fillimisht, vlera e ndihmës duhet të ulet në mënyrë proporcionale;
- iii) Afatet e reja kohore mund të zgjaten në krahasim me afatet kohore të miratuara fillimisht, vetëm për shkaqe që ndodhin jashtë kontrollit të ndërmarrjes ose të dhënësit. Në rast të kundërt, vlera e ndihmës duhet të ulet në mënyrë proporcionale.

Neni 14

Monitorimi dhe raportet vjetore për planin e ristrukturimit

1. Dhënësit duhet të paraqesin pranë drejtorisë raporte vjetore për zbatimin e planeve të ristrukturimit, të pranuar nga komisioni jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës. Këto raporte do të vazhdojnë të paraqiten, derisa objektivat e planit të ristrukturimit të vlerësohen të përmbushura.

2. Raportet duhet të përmbajnë këto të dhëna:

- a) Emrin e ndërmarrjes;
- b) Nëse është rasti, çdo ndihmë të dhënë për ristrukturim ose çdo mbështetje tjetër, që vlerësohet ndihmë, të cilën ndërmarrja përfituese e ka marrë në mënyrë individuale ose në kuadër të një skeme të përgjithshme gjatë periudhës së ristrukturimit;
- c) Afatet kohore për pagesat që i bëhen ndërmarrjes dhe për financimin e saj;
- d) Zbatimin e kushteve dhe të detyrimeve, të përcaktuara në vendimin që ka miratuar ndihmën;
- e) Çdo informacion tjetër të vlefshëm, që mundëson komisionin të mbikëqyrë zbatimin e planit të ristrukturimit.

3. Komisioni mund të kërkojë paraqitjen më të shpeshtë të raporteve, kur i nevojitet një konfirmim i shpejtë për informacione të rëndësishme.

Neni 15

Monitorimi dhe raportet vjetore për skemat e ndihmës për shpëtim dhe ristrukturim

1. Dhënësit duhet të paraqesin pranë drejtorisë raporte vjetore për skemat e ndihmës, të dhëna për shpëtim dhe ristrukturim, jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës.
2. Raportet duhet të përmbajnë këto të dhëna:
 - a) Emrin e ndërmarrjes;
 - b) Numrin e punonjësve;
 - c) Xhiron vjetore dhe vlerën e bilancit;
 - d) Vlerën e ndihmës së dhënë;
 - e) Vlerën dhe formën e kontributit të përfituesit;
 - f) Kur është rasti, formën dhe shkallën e masave kompensuese;
 - g) Kur është rasti, çdo ndihmë ristrukturimi ose mbështetjeje tjetër, që vlerësohet ndihmë, që ndërmarrja përfituese ka marrë në të kaluarën;
 - h) Nëse ndërmarrja përfituese ka qenë subjekt i procedurave të falimentimit kolektiv përpara përfundimit të periudhës së ristrukturimit.
3. Kur i nevojitet një konfirmim i shpejtë, për informacione të rëndësishme, komisioni mund të kërkojë paraqitjen më të shpeshtë të raporteve.

Neni 16

Nxjerrja e udhëzuesve dhe e dokumenteve të tjera operationale

Në zbatim të kësaj rregulloreje, komisioni mund të nxjerrë udhëzuesin dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm.

VENDIM

Nr.817, datë 28.12.2005

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PROCEDURAT DHE FORMËN E NJOFTIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 20, pika 4, e 36 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e rregullore “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

RREGULLORE

PËR PROCEDURAT DHE FORMËN E NJOFTIMIT

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave dhe i përmbajtjes së formës së njoftimit, në përputhje me të cilat dhënësit e ndihmës shtetërore (në vazhdim “dhënës”) do të njoftojnë planet për dhënien e një ndihmë të re ose ndryshimin e një ndihme ekzistuese, si dhe procedurat për vlerësimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e ndihmës shtetërore nga strukturat e kontrollit të ndihmës shtetërore.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

“Ndhmë shtetërore ekzistuese” është çdo skemë e ndihmës shtetërore dhe e ndihmës individuale, e dhënë para hyrjes në fuqi të ligjit dhe që zbatohet edhe pas hyrjes në fuqi të tij, si dhe çdo skemë e ndihmës shtetërore dhe e ndihmës individuale, që është miratuar në përputhje me ligjin dhe këtë rregullore.

“Ndhmë shtetërore e re” është çdo skemë e ndihmës dhe çdo ndihmë individuale, që nuk është ndihmë ekzistuese, përfshirë edhe ndryshimet e ndihmës ekzistuese.

“Ndryshimi i ndihmës ekzistuese” është çdo ndryshim që i bëhet masës së ndihmës, me përjashtim të ndryshimeve të natyrës zyrtare apo administrative, që nuk sjell ndikim në vlerësimin e përputhshmërisë së ndihmës me dispozitat e ligjit.

“Ndhmë e paligjshme” do të konsiderohet çdo ndihmë sipas përcaktimit të bërë në ligj.

“Palë të interesuara” janë përfituesit e ndihmës, si dhe ndërmarrjet konkurruese e bashkimet e tyre, interesi i të cilave mund të cenohet nga dhënia e ndihmës.

Neni 3
Detyrimi për njoftimin e ndihmës së re

1. Dhënësit e ndihmës njoftojnë pranë Drejtorisë së Ndhmës Shtetërore (në vazhdim “drejtoria”) çdo plan për dhënien e një ndihme të re, pavarësisht nga forma e saj dhe nga përfituesit. Përfituesit e ndihmës nuk kanë të drejtë të njoftojnë asnjë plan ndihme pranë drejtorisë.

2. Ndhma e njoftuar sipas pikës 1, nuk duhet të vihet në zbatim para se komisioni të ketë marrë një vendim për lejimin e saj, me ose pa kushte.

Neni 4
Përjashtimi nga detyrimi për njoftim

Ndihmat shtetërore, të përcaktuara në nenin 7 të ligjit, si dhe skemat e ndihmës ekzistuese përjashtohen nga detyrimi për njoftim.

KREU II
PROCEDURAT PËR NDIHMËN E RE

Neni 5
Forma e njoftimit

1. Ndihmat shtetërore njoftohen duke plotësuar formularin e njoftimit, të përcaktuar në aneksin I të kësaj rregulloreje. Për ndihmën shtetërore, të dhënë në bazë të neneve 14 e 15, të ligjit, njoftimi bëhet duke plotësuar formularët e veçantë të njoftimit.

2. Formulari i njoftimit duhet të plotësohet me informacionin e duhur, të saktë dhe të plotë, në mënyrë që komisioni të vlerësojë përputhshmërinë e ndihmës shtetërore, për të cilën është kërkuar miratimi, me dispozitat e ligjit.

3. Kur formulari i njoftimit është nënshkruar nga përfaqësuesit e dhënësve, ata duhet të paraqesin autorizim me shkrim.

4. Kur një dhënës planifikon të japë disa ndihma shtetërore, ai duhet të plotësojë për secilin plan të ndihmës nga një formular të veçantë njoftimi.

Neni 6
Paraqitja e formularit të njoftimit

1. Kopje origjinale dhe dy kopje të tjera të formularit të njoftimit, së bashku me dokumentet shoqëruese dorëzohen në drejtori. Njoftimi duhet të dorëzohet në adresën e përcaktuar në nenin 25 të kësaj rregulloreje.

2. Dokumentet shoqëruese mund të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Dhënësi do të konfirmojë që ato të jenë të plota.

3. Njoftimi është i vlefshëm në datën e marrjes në dorëzim nga drejtoria. Nëse informacioni që përmban formulari i njoftimit është i paplotë, atëherë ky njoftim bëhet i vlefshëm vetëm nga data kur në drejtori të paraqitet formulari i njoftimit me të dhëna të sakta e të plota.

4. Drejtoria duhet të informojë, menjëherë, me shkrim, dhënësin për datën në të cilën bëhet i vlefshëm njoftimi.

Neni 7

Kërkesë për informacion shtesë

1. Kur drejtoria gjykon se informacioni i marrë nga dhënësi është i paplotë, ajo i kërkon atij, brenda 15 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, informacionin e nevojshëm shtesë, si dhe përcakton një afat kohor, brenda të cilit duhet të paraqitet ky informacion.

2. Kur dhënësi nuk jep informacionin e kërkuar ose jep informacion të paplotë, brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, drejtoria i dërgon atij një shkresë, ku i rikujton kërkesën për informacion shtesë dhe përcakton një afat kohor shtesë, brenda së cilit duhet të jepet informacioni.

3. Njoftimi quhet i tërhequr, nëse informacioni i kërkuar nuk është dhënë brenda afatit të parashikuar, përveç rasteve kur:

- a) para përfundimit të kësaj periudhe, afati është zgjatur me miratimin e drejtorisë dhe të dhënësit;
- b) dhënësi paraqet me shkrim argumentet, nëpërmjet të cilave i kërkon drejtorisë ta vlerësojë njoftimin të plotë, për shkak se informacioni shtesë i kërkuar nuk është i disponueshëm ose tashmë është dhënë.

Nëse njoftimi quhet i tërhequr, drejtoria duhet të njoftojë dhënësin për të.

Neni 8

Tërheqja nga njoftimi

1. Dhënësi mund ta tërheqë njoftimin përpara se komisioni të ketë marrë një vendim, sipas nenit 22 të ligjit.

2. Kur dhënësi tërheq njoftimin, komisioni duhet të mbyllë procedurën.

Neni 9

Revokimi i vendimit

1. Komisioni mund të revokojë një vendim për miratimin e një ndihme shtetërore, në rast se pas miratimit është vënë re se vendimi është mbështetur në informacion të pasaktë nga ana e dhënësit, informacion i cili ka qenë i rëndësishëm në marrjen e vendimit.

2. Përpara revokimit të vendimit dhe marrjes së vendimit të ri, komisioni duhet të dëgjojë argumentet e dhënësit dhe të palëve të interesuara.

Neni 10

Ndryshimet

1. Kur dhënësi ndryshon kushtet e dhënies së ndihmës, para se komisioni të marrë vendimin, këto ndryshime duhet të paraqiten, me shkrim, menjëherë pranë drejtorisë. Në rast se ndryshimet ndikojnë në vlerësimin e masave të ndihmës, drejtoria, pasi të jetë këshilluar me komisionin, duhet të informojë dhënësin për këtë dhe mund t'i kërkojë atij të ndryshojë apo të paraqesë një formular të ri njoftimi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet edhe kur dhënësi ndryshon një ndihmë ekzistuese, përveç rasteve të parashikuara në nenin 13 të kësaj rregulloreje.

Neni 11

Procedura e thjeshtuar e njoftimit

1. Njoftohen në bazë të formularit të thjeshtuar të njoftimit, të paraqitur në aneksin II të kësaj rregulloreje, ndryshimet e mëposhtme të ndihmës ekzistuese:

- a) rritjet e buxhetit të një skeme të miratuar me më shumë se 20 për qind;
- b) zgjatja e një skeme ekzistuese të miratuar për një periudhë 6-vjeçare, me ose pa rritje në buxhet;
- c) kufizim i një skeme ekzistuese të miratuar, ulje e intensitetit të ndihmës ose ulje e shpenzimeve

të pranueshme.

2. Ndryshimet, zyrtare dhe administrative, si dhe rritjet në buxhetin fillestar të një skeme ndihme të miratuar, në më pak se 20 për qind, nuk vlerësohen si ndryshime të një ndihme ekzistuese dhe, si pasojë, nuk kërkojnë njoftim.

3. Për çdo ndihmë të njoftuar me anë të formularit të thjeshtuar të njoftimit, komisioni duhet të marrë një vendim, brenda 30 ditëve kalendarike.

4. Procedura e thjeshtuar e njoftimit nuk duhet të përdoret për përpunimin e ndryshimeve të skemave të ndihmës, për të cilat dhënësit nuk kanë paraqitur raportet vjetore sipas neneve 32 dhe 35 të ligjit, me përjashtim të rasteve kur raportet vjetore, për vitet në të cilat është dhënë ndihma, janë paraqitur në të njëjtën kohë me njoftimet.

KREU III PROCEDURAT PËR NDIHMËN E PALIGJSHME

Neni 12

Njoftimi

1. Dhënësi i një ndihme të panjoftuar dhe të pamiratuar, mund të njoftojë për këtë ndihmë pranë drejtorisë, duke plotësuar formularin e njoftimit, të dhënë në aneksin I. Vlerësimi i njoftimeve të tilla nuk pengon zbatimin e neneve 26, 27 dhe 28 të ligjit.

2. Në rast se kërkohet informacion shtesë, parashikimet e nenit 7 të kësaj rregulloreje zbatohen edhe për pikën 1 të këtij neni.

Neni 13

Masat e përkohshme

1. Komisioni mund të marrë një vendim, që kërkon nga dhënësi i ndihmës pezullimin e zbatimit të çdo ndihme të paligjshme, derisa komisioni të ketë marrë një vendim për lejueshmërinë e kësaj ndihme.

2. Komisioni mund të marrë një vendim, për të kërkuar nga dhënësi i ndihmës, që, në mënyrë të përkohshme, të kthejë çdo ndihmë të paligjshme, për sa kohë që komisioni nuk ka marrë një vendim për lejueshmërinë e ndihmës.

3. Komisioni merr një vendim sipas pikës 2 të këtij neni, nëse përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) nuk ka dyshim që masa në fjalë përbën ndihmë shtetërore;

b) ka urgjencë për të vepruar;

c) ekziston një rrezik serioz për shkaktimin e një dëmi të konsiderueshëm dhe të pariparueshëm për një konkurrent.

4. Kthimi i përkohshëm kryhet në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenet 27 dhe 28 të ligjit. Pasi ndihma të jetë kthyer, komisioni duhet të marrë një vendim, brenda afatit kohor, që zbatohet për ndihmën e njoftuar.

Neni 14

Metoda për zbatimin e normave të interesit

1. Norma e interesit, që zbatohet për kthimin e ndihmës së paligjshme, do të jetë norma e zbatueshme në datën kur ndihma e paligjshme është vënë për herë të parë në dispozicion të përfituesit.

2. Norma e interesit do të zbatohet si një interes i përbërë. Interesi i përshtuar vitin paraardhës do të jetë subjekt i interesit për çdo vit pasardhës.

3. Norma e interesit, e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, do të zbatohet gjatë gjithë periudhës deri në datën e kthimit. Në rast se kanë kaluar më shumë se pesë vjet nga data kur ndihma e paligjshme është vënë për herë të parë në dispozicion të përfituesit, deri në datën e kthimit të ndihmës, norma e interesit do të rillogaritet me intervale kohore pesëvjeçare, duke marrë për bazë normën e interesit në fuqi në çastin e rillogaritjes.

Neni 15

Metoda për përcaktimin e normës së interesit

1. Norma e interesit që do përdoret për kthimin e ndihmës shtetërore të dhënë, jepet si normë përqindjeje vjetore, fikse, për çdo vit kalendarik.

2. Norma e interesit do të llogaritet në bazë të mesatares së normës së këmbimeve ndërbankare për muajt shtator, tetor, nëntor, të periudhës paraardhëse pesëvjeçare, duke i shtuar edhe 0.75 për qind. Kur e sheh të arsyeshme, komisioni mund të rrisë normën e interesit me më shumë se 0.75 për qind.

3. Nëse mesatarja e fundit tremujore e normës pesëvjeçare, të disponueshme të këmbimit ndërbankar, plus 0.75 për qind, ndryshon me shumë se 15 për qind nga norma e interesit në fuqi për kthimin e ndihmës shtetërore, komisioni do ta rillogarisë këtë të fundit.

4. Norma e re do të zbatohet që nga dita e parë e muajit pas rillogaritjes nga komisioni.

5. Në mungesë të të dhënave të besueshme apo të barasvlefshme, ose në rrethana përjashtimore, komisioni mund të caktojë një normë interesi për kthimin e ndihmës shtetërore në bazë të një metode tjetër dhe në bazë të një informacioni të vlefshëm për të.

Neni 16

Publikimi i normave të interesit për kthimin e ndihmës shtetërore

Komisioni publikon normën në fuqi të interesit, rillogaritjet, si dhe format e mëparshme të interesit për kthimin e ndihmës shtetërore në një gazeta të shtypit periodik me tirazhin më të madh.

Neni 17

Afati i parashkrimit

1. Komisioni mund të kërkojë kthimin e ndihmave të paligjshme brenda një periudhe 10-vjeçare.

2. Afati i parashkrimit fillon ditën, në të cilën ndihma e paligjshme i është dhënë përfituesit të saj, si një ndihmë individuale apo si një skemë e ndihmës shtetërore. Çdo veprim i ndërmarrë nga komisioni ose nga dhënësi i ndihmës, që vepron me kërkesën e komisionit, në lidhje me ndihmën e paligjshme, ndërpret afatin kohor. Çdo ndërprerje shkakton rifillimin e llogaritjes së afatit të parashkrimit. Nëse vendimi i komisionit është apeluar në Gjykatën e Tiranës, afati i parashkrimit do të pezullohet deri në përfundimin e procedurave gjyqësore.

Çdo ndihmë, së cilës i ka kaluar afati i parashkrimit, vlerësohet ndihmë ekzistuese.

KREU IV

PROCEDURAT PËR SKEMAT EKZISTUESE TË NDIHMËS

Neni 18

Bashkëpunimi me dhënësit

1. Drejtorja merr nga dhënësit të gjithë informacionin e nevojshëm për rishikimin e skemave ekzistuese të ndihmës.

2. Kur drejtorja vlerëson se një skemë ekzistuese e ndihmës nuk është në përputhje me ligjin, ajo duhet të njoftojë dhënësin për gjykimet e saj paraprake dhe t'i japë atij mundësinë të paraqesë komentet e veta brenda një afati kohor të arsyeshëm, por jo më vonë se 30 ditë-punë.

Neni 19

Propozim për masat e përshtatshme

Komisioni mund të propozojë, në mbështetje të nenit 23 të ligjit, masat e nevojshme për të përshtatur ndihmën shtetërore ekzistuese me dispozitat e ligjit. Rekomandimi për t'i propozuar dhënësit masat e nevojshme, duhet të përfshijë në veçanti:

- a) amendime të rëndësishme të skemës së ndihmës;
- b) përfshirjen e kërkesave procedurale;
- c) shfuqizimin e skemës së ndihmës.

Neni 20

Pranimi i masave të propozuara

1. Kur dhënësi pranon masat e propozuara, drejtoria e regjistron këtë fakt dhe informon me shkrim dhënësin.
2. Dhënësi është i detyruar, me këtë pranim, që të zbatojë masat përkatëse.
3. Kur komisioni vlerëson se dhënësit nuk i zbatojnë masat përkatëse, ai vendos fillimin e procedurave për ndihmën e paligjshme.

Neni 21

Refuzimi i masave të propozuara

Kur dhënësi nuk pranon masat e propozuara dhe komisioni, pasi ka marrë parasysh argumentet e dhënësit të interesuar, vazhdon t'i vlerësojë të nevojshme këto masa, ai mund të vendosë fillimin e procedurave për ndihmën e paligjshme.

KREU V

PALËT E INTERESUARA

Neni 22

Të drejtat e palëve të interesuara

1. Pas publikimit të njoftimit të ndihmës së re në një gazetë të shtypit periodik me tirazhin më të madh, çdo palë e interesuar mund të paraqesë komentet e veta.
2. Çdo palë e interesuar mund të informojë drejtorinë, nëse gjykohet se ndihma është e paligjshme. Kur drejtoria vlerëson se informacioni që ka në zotërim nuk është i mjaftueshëm, ajo ia paraqet këtë informacion për shqyrtim komisionit, i cili merr vendim për këtë çështje.
3. Kur drejtoria ka në zotërim një informacion të mjaftueshëm për të marrë çështjen në shqyrtim, i kërkon dhënësit të paraqesë të gjithë informacionin e nevojshëm për shqyrtimin e plotë të çështjes.
4. Me kërkesën e vet, çdo palë e interesuar do të marrë një kopje të vendimit të dhënë, sipas parashikimit të pikës 2 të nenit 22 të ligjit.

KREU VI

PROCEDURAT PËR RAPORTIM DHE MONITORIM

Neni 23

Raporti vjetor

1. Dhënësi do të paraqesë pranë drejtorisë raportet vjetore për skemat e ndihmës shtetërore dhe ndihmës individuale të dhënë, jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës. Forma dhe përmbajtja e raportit vjetor janë parashikuar në aneksin III të kësaj rregulloreje.
2. Çdo tremujor, drejtoria mund të kërkojë nga dhënësit informacion për ndihmën shtetërore të dhënë e, në veçanti, të dhëna për përdorimin e saj.
3. Kur pas shqyrtimit të informacionit të dhënë në raportin vjetor dhe të çdo informacioni tjetër të paraqitur nga dhënësi, drejtoria ka dyshime për përputhshmërinë e ndihmës shtetërore me dispozitat e ligjit, ajo duhet t'i kërkojë dhënësit të paraqesë informacion shtesë. Drejtoria duhet të përcaktojë informacionin që kërkohet, si dhe afatin kohor, brenda të cilit duhet të sigurohet ky informacion.

Neni 24

Monitorimi në vend

1. Kur komisioni ka dyshime serioze për përmbushjen e vendimeve, për ndihmën individuale, sipas parashikimit të pikës 2 të nenit 22 të ligjit, dhënësi i ndihmës, pasi iu është dhënë mundësia të shprehin komentet e tyre, do të lejojë komisionin, që të bëjë kontrollin në vend.
2. Për të verifikuar përputhjen e vendimit të marrë për çështjen në fjalë, komisioni dhe/ose nëpunësit e autorizuar prej tij kanë të drejtë:
 - a) të hyjnë në mjediset e ndërmarrjes në fjalë;

- b) të kërkojnë shpjegime gojore në vend;
- c) të kontrollojnë librat dhe regjistrat e tjerë të biznesit, në formë të shkruar apo elektronike e të marrin ose të kërkojnë kopje të tyre.

3. Nëse e sheh të arsyeshme, komisioni ose drejtorja kërkon ndihmë nga ekspertë të pavarur.

KREU VII DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 25

Regjistrimi i njoftimeve

1. Drejtorja mban regjistrin e njoftimeve të ndihmës shtetërore, i cili është në formë të shkruar dhe elektronike.

2. Një kopje e njoftimit të regjistruar do të arkivohet pranë drejtorisë dhe një kopje në zyrën e arkivës pranë ministrisë, që mbulon çështjet e ekonomisë.

3. Drejtorja i konfirmon me shkrim dhënësit marrjen e njoftimit dhe të dokumenteve, që i bashkëlidhen, duke përshkruar shkurtimisht dokumentet e marra, numrin dhe vëllimin e tyre.

Neni 26

Marrja në dorëzim e dokumenteve nga drejtorja

Njoftimet dhe dokumentet e tjera që i bashkëlidhen, do të dorëzohen, në përputhje me nenit 6 të kësaj rregulloreje, në adresën e mëposhtme:

Drejtorja e Ndihmës Shtetërore
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” Nr.2
Tiranë

VENDIM Nr.822, datë 28.12.2005

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.127, DATË 11.3.2004, TË KESHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E KOMITETIT SHTETËROR TË MINORITETEVE”

Në mbështetje të neneve 20 dhe 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8496, datë 3.6.1999 “Për ratifikimin e konventës kuadër të Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e minoriteteve””, të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.127, datë 11.3.2004, të Këshillit të Ministrave të bëhen këto ndryshime:

a) Pika 5 të ndryshohet si më poshtë vijon:

“5. Komiteti Shtetëror i Minoriteteve kryesohet nga kryetari, nënkryetari dhe ka në përbërje 5 anëtarë. Kryetari i Komitetit Shtetëror të Minoriteteve, nënkryetari dhe anëtarët e këtij Komiteti, që propozohen nga kryetari, emërohen nga Kryeministri. Komiteti Shtetëror i Minoriteteve vendos me shumicën e votave të anëtarëve të vet.”.

b) Lidhja nr. 1 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare të përballohen nga buxheti i vitit 2005, miratuar për Komitetin Shtetëror të Minoriteteve.

3. Ngarkohet Komiteti Shtetëror i Minoriteteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Lidhja nr.1

EMËRTIMI	PAGA MUJORE			
	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT
	1	2	3	4
	Paga e grupit PG	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicionin (SHP)
Kryetar	9.306	2%	0	93.060
Nënkryetar	9.306	2%	0	76.516
Anëtar	9.306	2%	0	56.870
Specialist	9.306	2%	0	20.680

VENDIM
Nr.825, datë 28.12.2005

PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË STATISTIKAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 10 të ligjit nr.9180, datë 5.2.2004
“Për statistikët zyrtarë” me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Emërimin e anëtarëve të Këshillit të Statistikave, si më poshtë vijon:

Përfaqësues nga bota akademike të jenë:

- Z.Dhori Kule anëtar;
- Znj.Areti Stringa anëtare;
- Z.Bardhyl Çeku anëtar.

Përfaqësues nga shoqëria civile të jenë:

- Z.Mero Baze anëtar;
- Z.Kreshnik Spahiu anëtar;
- Znj.Mirlinda Rusi anëtare.

Përfaqësues nga agjencitë statistikore të jenë:

- Z.Kliti Ceca anëtar;
- Z.Ylber Bezo anëtar;
- Znj.Besa Peci anëtar;
- Z.Kostandin Kazanxhi anëtar;
- Z.Dorian Deltina anëtar.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Fletorja Zyrtare gjendet: duke u abonuar pranë njësive postare të qyteteve ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare; në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot" Tel: 042 555 63; 267 468
Për më tepër informacion vizitoni faqen e internetit:
www.legjislacionishqiptar.gov.al ose www.qpz.gov.al

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

REGJISTRAT E NOTERISË SIPAS FORMATIT TË MIRATUAR NGA MINISTRIA E DREJTËSISË 2005

1. REGJISTRI I PËRGJITHSHËM I AKTEVE DHE I VEPRIMEVE NOTERIALE	1000
2. REGJISTRI I TESTAMENTEVE	500
3. REGJISTRI I DEPOZITIMIT TË PARAVE OSE VLERAVE TË TJERA	500
4. INDEKSI ALFABETIK	600

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK.....	1500
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (Botim, 2005)	600
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë).....	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET.....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004 ...	1500
2. TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004.....	2000

BOTIME TË REJA

1. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim i II-të)	1500
2. KODI DOGANOR.....	1000
3. KODI DETAR	1000

Doli nga shtypi më 9.1.2006

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Mësonjëtorja"
Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë